



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	12.11.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Shpresa Zariqi - Shefe e divizionit për Bashkëpunim në ABGJ
Cc:	Zt. UD.SP.ZKM Arben Krasniqi Zt. Isa Hajdari
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi zyrtarja: Liridona Kastrati Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Agjencia për Barazi Gjinore me përfaqësuese Shpresa Zariqi - Shefe e divizionit për Bashkëpunim në ABGJ që me datën 25.11.2021 në Sheshin "Skënderbeu" afër ndërtesës së Qeverisë ku do të realizojë një instalacion do të vendosen reflektorë me ngjyrë portokalli që do të mundësojnë ndriçimin e ndërtesës duke filluar nga ora 17:00 deri në ora 00:00.

Aktiviteti do të realizohet për nder të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Femijëve.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohëshme në pronën publike nr.01-110-157481, i jep:

Pëlqimin

Agjencisë për Barazi Gjinore me përfaqësuese Shpresa Zariqi - Shefe e divizionit për Bashkëpunim në ABGJ që me datën 25.11.2021 në Sheshin "Skënderbeu" afër ndërtesës së Qeverisë ku do të realizojë një instalacion do të vendosen reflektorë me ngjyrë portokalli që do të mundësojnë ndriçimin e ndërtesës së Qeverisë duke filluar nga ora 17:00 deri në ora 00:00.

Aktiviteti do të realizohet për nder të shënimit të Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.